



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE
PLATFORMËS SË BASHKËQEVERISJES**

Nr.10071/1 prot.

Tiranë, më 09.10.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Z. Rr

Adresa: Barrdhaj, Shkodër

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar me nr.3175 prot., datë 21.3.205, ju sqarojmë se:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, bazuar në Ligjin nr 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, fillimisht ju ka caktuar pension pleqërie, me vendim caktimi pensioni nr. 49, datë 21.01.2025, me 24 vite e 11 muaj periudhë sigurimi, me datë fillimi pagese 03.01.2025 dhe masë fillestare pensioni 20, 474 lekë.

DRSSH Shkodër, ju ka rishqyrtuar pensionin me vendimin nr. 49/1, datë 14.02.2025, duke shtuar periudhën e punës 01.07.1978-30.05.1982 në ish koop. bujq. Shllak, Temal dhe periudhën e punës 01.06.1982-19.07.1991 pranë ish koop.bujq Shosh, me ditë të plota, sipas vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. 1501(6456), datë 18.12.2019, (ku vjetërsia e njohur sipas vendimit rezulton 13 vite e 18 ditë).

Në llogaritjen e vjetërsisë së punës për efekt pensioni janë përfshirë periudhat si më poshtë:

- 01.02.1999 - 31.08.2002, 01.10.2002 - 31.12.2003, 01.04.2004 - 30.11.2004, 01.04.2005 - 30.09.2005, 01.01.2006 - 31.07.2006, 01.09.2006 - 31.12.2006 (6 vite e 11 muaj) pranë "Komunës Shosh", sipas vërtetimit nr.123, datë 15.01.2025, lëshuar nga Dega e Arkivës, DRSSH Shkodër.
- 01.01.2007 - 02.01.2024 (18 vite e 1 ditë) pranë "Qendra Shëndetësore Shosh-Shalë", sipas vërtetimit nr.123, datë 15.01.2025, lëshuar nga Dega e Arkivës, DRSSH Shkodër dhe vërtetimit të datës 13.01.2025, nga sistemi CMIS.

- 01.07.1978-30.05.1982 në ish koop. bujq. Shllak, Temal 1978 - 1991 pranë ish Kooperativës Bujqësore Shllak Temal
- 01.06.1982-19.07.1991 pranë ish Koop.Bujq Shosh,dhe ish Kooperativës Bujqësore Shosh:Bujqësore Shosh.

Gjithashtu, referuar kontrollit në të gjitha sistemet e vjetërsisë në punë (DMAIS), në shtet e kooperativë bujqësore, para vitit 1994, në sistemin (CMIS) të tatimeve pas vitit 2012 dhe sipas vertetimit nr.70/MK, datë 21.01.2025 nuk ju rezulton periudhe vjetërsi tjetër.

Në llogaritjen e vjetërsisë së punës nuk janë përfshirë periudhat si më poshtë:

- 1978 - 1991 pranë ish Kooperativës Bujqësore Shllak Temal dhe ish Kooperativës Bujqësore Shosh:Bujqësore Shosh, pasi Vendimi nr. 1501, datë 18.12.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk është zbatuar nga DRSSH Shkodër, pasi nuk i është komunikuar zyrtarisht dhe nuk ka marrë formë të prerë. Sipas neneve 44 dhe 48 të Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", një vendim gjykate është i zbatueshëm vetëm pasi të ketë marrë formë të prerë. Pas marrjes së formës së prerë të vendimit të mësipërm, ju duhet të riaplikoni në portalin e-Albania për "Rishqyrtim Pensioni Pleqërie" dhe të dorëzoni dokumentacionin përkatës me postë pranë DRSSH Shkodër.

- Periudhat e deklaruara pranë subjektit "Komuna Shosh": 01.06.2008 - 31.01.2009; 01.09.2002 - 30.09.2002; 01.01.2004 - 31.03.2004; 01.12.2004 - 31.03.2005; 01.10.2005 - 31.12.2005; 01.08.2006 - 31.08.2006, pasi sipas vërtetimit nr.123, me datë 15.01.2025 lëshuar nga Dega e Arkivës, emri juaj nuk rezulton në listpagesat e këtij subjekti, (nuk janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për këtë periudhë).

Në përgjigje të kërkesës suaj për rishqyrtim pensionit të datë 07.02.2025, ku keni dorëzuar vendimin e gjykatës për periudhat **01.06.1982 - 19.07.1991**, pranë ish Kooperativës Bujqësore Shosh, Dega e Përfitimeve pranë DRSSH Shkodër, me vendim rishqyrtimi pensioni nr. 49/1, datë 14.02.2025, ka rishqyrtuar pensionin duke shtuar periudhën e punës 01.07.1978-30.05.1982 në ish koop. bujq. Shllak, Temal dhe periudhën e punës 01.06.1982-19.07.1991 pranë ish koop.bujq Shosh, me ditë të plota, sipas vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. 1501(6456), datë 18.12.2019, (vjetërsia e njohur rezulton 13 vite e 18 ditë).

Si rezultat, masa fillestare e pensionit tuaj është rritur nga 20,474 lekë në 26,352 lekë në muaj, ndërsa periudha e sigurimit është shtuar nga 24 vite e 11 muaj në 38 vite, me të drejtë pagese nga data 03.01.2025.

Gjithashtu, nga rishqyrtimi i pensionit, keni përfituar një diferencë kreditore për periudhën 03.01.2025 - 30.01.2025, në vlerën 19,109 lekë, e cila ju është kaluar në muajin shkurt 2025 së bashku me pensionin mujor të rishqyrtuar.